

## CleanScore shpalli fituesit e edicionit të tretë të “Konkursi i Punimeve Kërkimore”

CleanScore shpalli fituesit e edicionit të tretë të “Konkursi i Punimeve Kërkimore”. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm pedagogë, studentë, përfaqësues nga zyrat e karrierës, fituesit e edicioneve të mëparshme si dhe pjesëmarrësit e këtij edicioni. Finalja e këtij konkursi solli 33 punime cilësorë nga universitete publike dhe private. Risi e këtij edicioni ishte pjesëmarrja e konkurrentëve nga diaspora. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u përfaqësua nga studentja, Argesta Stërgu, e cila fitoi çmimin e tretë.

